



15



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

MBI POTENCIALET E INVESTIMEVE DHE SEKTORËT PRIORITARË

Tiranë, Tetor 2019

Ky dokument pune është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve në kuadër të mbledhjes XVIII të Këshillit të Investimeve (4 tetor 2019), z. Elvis Zerva, ekspert ligjor dhe rregullator, znj. Elida Fara, eksperte për ekonominë, znj. Xaira Shurdha, eksperte për monitorimin dhe ndërlidhjen, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Ndihejmo në organizimin e takimeve me partnerë dhe redaktimin gjuhësor të materialit, znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit pranë Sekretariatit. Një falenderim i veçantë për administratorët/drejtorët ekzekutivë të kompanive private (shqiptare dhe të huaja) dhe shoqatat e biznesit që bashkëpunuan me Sekretariatin në parashtrimin e problematikave, si edhe ekspertët e pavarur, përfaqësuesit e institucioneve publike (MIE, AKBN, MBZHR, BSH, AIDA) dhe ambasadave/donatorëve për kontributin e shkëlqyer në ofrimin e informacionit përkatës.

LISTA E SHKURTIMEVE

AIDA	Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve
ALL	Albanian Lek
BB	Banka Botërore
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ETTC	Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit
FKBF	Formimi i Kapitalit Bruto Fiks
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KI	Këshilli i Investimeve
KIS	Komiteti i Investimeve Strategjike
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
p.p.	Pikë përqindje
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPP	Partneriteti Publik dhe Privat
REA	Reforma për Zonën Ekonomike Rajonale
RIRA	Axhenda për Investimet
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TEDA	Zonat Ekonomike
TIK	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBAJTJA


HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
KONTEKSTI	8
ORIENTIMI NDAJ POTENCIALEVE TË RRRITJES EKONOMIKE	11
GJETJE	16
SUGJERIME	24
SHTOJCA 1	27
SHTOJCA 2	30
BIBLIOGRAFIA	38

HYRJE

Ndryshimi i modelit ekonomik, sipërmarrja e lirë dhe hapja ndaj tregut bënë që Shqipëria të përjetonte rritje të konsiderueshme ekonomike pas viteve 90. Vendi u gjend përpara sfidës së rimodelimit ekonomik për të mundësuar rritje të qëndrueshme, ku e drejta e pronës, sipërmarrja e lirë dhe integrimi me ekonominë e vendeve të tjera u bënë shtyllat e reja ku do të mbështetej zhvillimi ekonomik dhe social i vendit. Nga pikëpamja sektoriale, sektorët krye-

sorë që mbështesnin ekonominë e vendit ishin industria (58% e PBB) dhe bujqësia (25%¹ e PBB). Ndërkohë, ndryshimet që vijuan sollën transformimin e strukturës së ekonomisë shqiptare². Sektorë të rinj të panjohur filluan të lulëzojnë dhe aktualisht struktura e ekonomisë është përqendruar tek “shërbimet” të cilat sigurojnë rreth 50% të PBB, e ndjekur nga “bujqësia” me 19%, “industria nxjerrëse dhe përpunuese” me 9% dhe sektori i “ndërtimit” me rreth (9%) të PBB.

Figura 1. Rritja ekonomike në Shqipëri, 1981-2018



Burimi: Instat


- ¹ E organizuar në format e kooperativave bujqësore.
- ² Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 1991, kontributi i Industrisë në Prodhimin e Brendshëm Bruto ishte rreth 58%, kryesisht e përqendruar në industrinë ushqimore (26%), industria e lehtë përpunuese (19%) dhe industria nxjerrëse (14%). Sektori i dytë më i madh kontribues ishte bujqësia me rreth 25% të totalit i ndjekur nga sektori i ndërtimit me rreth 8%.

Bazuar në analizat më të fundit të Bankës Botërore (BB)³ mbi Ballkanin Perëndimor rezultoi se trendi i rritjes është pozitiv krahasuar me vendet e BE⁴, por perspektiva e rritjes ndryshon nga vendi në vend, p.sh. rritja do të përshpejtohet në

³ Western Balkans Regular Economic Report, Spring 2019

⁴ Ku rritja mesatare për periudhën 2019-2020 parashikohet në 3,7% në ulje nga rritja prej 3,8% e vitit 2018.

Figura 2. Perspektiva e Rritjes në Rajon, 2018-2020



Burimi: Banka Botërore

Një studim i BB⁵ vlerëson, se një mundësi që Shqipëria dhe vendet e Ballkanit Perëndimor të sigurojnë rritje të qëndrueshme është që të ribalancojnë rritjen ekonomike nga *konsumi* drejt *investimeve*, nga *kërkesa e brendshme* drejt asaj *të jashtme* dhe nga *sektori publik* drejt *sektorit privat*. Për këtë, në kuadrin e integritimit në ekonominë globale, vende të vogla si Shqipëria⁶ kanë nevojë për të gjetur “*nichen*” e tyre në zinxhirin global ekonomik.

⁵ WB “The Western Balkans reviving up the engine to growth and prosperity” (2017)

⁶ Krahasuar me vitin 1990 Shqipëria e ka rritur PBB e saj me 2,4 herë duke u rritur me norma relativisht të larta, mesatarisht 7,8% në vit, ndërkohë që pas krizës financiare ekonomia e Shqipërisë e ngadalësoi rritjen në një mesatare vjetore prej 2,7% duke mos arritur më nivelet e parakrizës.

Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut dhe do të ulet kryesisht në Shqipëri dhe Mal të Zi. Përfundimi i dy projekteve madhore energjitike në Shqipëri do të ndikojnë uljen e rritimit të rritjes ekonomike.

Në këtë kuadër, objekti i analizës në këtë dokument është stimulimi i debatit mbi opsionet e rritjes së qëndrueshme të investimeve dhe burimeve potenciale. Analiza fokusohet në dinamikat e fundit të rritjes ekonomike në vend, evidencimin e perceptimeve të sektorit privat, mbi nevojën e një tregu ku parimet e qëndrueshmërisë në afat të gjatë nxisin rritjen dhe mundësojnë një optimum midis kapitalit të natyrës, fuqisë punëtore, social dhe financiar.

Dokumenti për Diskutim nuk jep rekomandime shteruese për adresimin e problematikave të sjella në nivelin strategjik apo sektorial, por tenton të nxisë diskutimet profesionale lidhur me modelin e zhvillimit të sektorëve prioritarë.

METODOLOGJIA

Hapat e ndërmarra nga Sekretariati për të stimuluar debatin mbi investimet, modelin dhe potencialet e zhvillimit të sektorëve të rinj janë si më poshtë vijon:

- Hulumtimi i strategjive, dokumentave, ligjeve dhe akteve nënligjore⁷ në lidhje me politikën dhe masat konkrete për nxitjen dhe zhvillimin e investimeve në vend. Hulumtimi i raporteve ndërkombëtare si *EU Progress Report 2019*, *US Department of State Investment Climate Statement 2019*, *Western Balkan Regular Economic Report WB*, *World Economic Outlook IMF*, *OECD*, *UNCTAD* (për më shumë detaje, shiko Bibliografinë).
- Analiza e problematikave nga bizneset e veçanta dhe shoqatat e biznesit të depozituara në Sekretariat gjatë periudhës 2015-2019 dhe të regjistruara në mënyrë kronologjike në bazën e të dhënave të Sekretariatit.
- Konsultime të drejtpërdrejta me rreth 40 për-

faqësues të shoqatave të biznesit/institucione shtetërore/biznese (17 CEO)/si edhe përfaqësues të ambasadave. Takimet u realizuan mbi një pyetësor të strukturuar paraprakisht, dhe fokusuar në a) situatën aktuale, pritshmëritë mbi potencialet e rritjes së investimeve në vend, b) rolin e kuadrit ligjor dhe rregullator në tërheqjen e investimeve, si edhe c) pengesat kryesore që bizneset hasin në klimën e përgjithshme të investimeve. Bizneset e përgjedhur janë përfaqësues të sektorëve prioritarë kontribues në rritje, kryesisht në fushën e energjisë, turizmit dhe bujqësisë.

- Anketat e KI “Mbi Klimën e Investimeve” ndër vite, 2015-2018 (2019 në proces)
- Konsultime në nivel teknik mbajtur më 24 shtator 2019 me pjesëmarrës nga dhoma dhe shoqata të biznesit dhe ekspertë të pavarur me qëllimin për të diskutuar dhe validuar gjetjet paraprake të materialit dhe rekomandimet e mundshme.

⁷ Në kuadrin e proceseve integruese të vendit në BE dhe atyre në nivel rajonal është formalizuar tashmë Reforma për Zonën Ekonomike Rajonale (REA). Një komponent i REA është edhe axhenda për investimet (RIRA), e cila synon midis të tjerave edhe një harmonizim të kuadrit ligjor dhe rregullator të investimeve në vend me praktikën më të mira ndërkombëtare.

KONTEKSTI


Nga një vështrim i raporteve ndërkombëtare, theksojmë se Shqipëria ka përmirësuar pozitat e saj në treguesit e *Lirisë Ekonomike*⁸, dhe renditet e 52a nga 186 vende të studiuar. E përmirësuar paraqitet situata edhe në indikatorët e *Doing Business 2019*,⁹ ku Shqipëria ka përmirësuar 8 nga 10 indikatorët e studiuar. Ndërkohë, treguesit e *Perceptimit të Korrupsionit*¹⁰, e rendisin

Shqipërinë në vend të 99 nga 180 vende të studiuar, ndërsa në *treguesit e Konkurrueshmërisë Botërore 2019*, Shqipëria renditet e 76a nga 140 vende të marrë në konsideratë.

Në dekadën e fundit, rritja mesatare vjetore¹¹ ka qënë rreth 2,7% e mbështetur nga *sektori i shërbimeve që mbulon mesatarisht 46% të PBB, i ndjekur nga sektori i bujqësisë që mbulon mesatarisht 19% të PBB, sektori i industrisë dhe ndërtimit që mbulojnë përkatësisht 12% dhe 10% të PBB.*

Ekonomia është e mbështetur kryesisht në kërkesën e brendshme dhe *konsumi është motori që tërheq ekonominë duke dhënë edhe kontributin më të madh në rritjen ekonomike, mesatarisht 1,9¹²p.p.*

Figura 3. Struktura e Ekonomisë Shqiptare, 2010-2018




8 Indeksi i Lirisë Ekonomike, The Heritage Foundation 2019

9 World Bank, Doing Business 2019

10 Transparency International 2019

11 Seria e të dhënave në material mbulon periudhën 2010 – 2018

12 Mesatare vjetore 2010-2018



Burimi: Instat

Pas rritjes prej 4,1% të regjistruar në vitin 2018, sipas vlerësimeve më të fundit të INSTAT¹³, rritja mesatare e PBB në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 u ngadalësua dhe ekonomia u rrit me 2,3% (gjatë 6-mujorit i 2018, rritja mesatare ishte 4,3%), kryesisht si rezultat i kontributit negativ të aktivitetit të industrisë, energjisë dhe ujit.

Pavarësisht se ekzistojnë mendime të ndryshme nëse janë investimet publike apo investimet private ato që sigurojnë rritje të vazhdueshme dhe afatgjatë, ka një konsensus të përgjithshëm se *investimet janë faktor kryesor në rritjen ekonomike të vendeve*. Kështu, në analizën e Fondit Monetar Ndërkombëtar¹⁴ theksohet se *nevoja për investime në tregjet dhe ekonomitë në zhvillim mbetet faktor kyç dhe i pazëvendësueshëm*. Që nga fillimi i viteve 2000, shkalla e lartë e investimeve ka qënë faktori kryesor në rritjen ekonomike, konsiderueshëm më e lartë në tregjet dhe ekonomitë në zhvillim sesa në ekonomitë e zhvilluara, gjë që

ka ndihmuar edhe në ngushtimin e hendekut të të ardhurave në këto vende.

Gjithashtu, bazuar në raportin më të fundit publikuar nga UNCTAD¹⁵, flukset e IHD-ve në nivel global kanë vijuar rënien për të tretin vit radhazi. Në ekonomitë e zhvilluara, flukset kanë kapur pikën më të ulët të tyre që nga vitit 2004, ndërkohë që *në vendet në zhvillim, IHD-të kanë vijuar trendin e tyre rritës duke qënë të qëndrueshme*. Si rezultat, *përqindja e ekonomive në zhvillim në flukset botërore të IHD-ve ka kapur shifër rekord 54%*.


Shqipëria krahasuar me vendet e rajonit, paraqitet ndër vendet me fluksin më të lartë të investimeve të huaja që nga viti 2010, si në vlerë, e renditur pas Serbisë edhe në raport me PBB-në, e renditur pas Malit të Zi. Ashtu siç shihet edhe nga grafiku më poshtë, Serbia është vendi më tërheqës për IHD në rajonin e Ballkanit Perëndimor, e cila pavarësisht luhatshmërive ka patur gjithmonë fluket më të larta të IHD.

13 INSTAT 2019

14 World Economic Outlook

15 UNCTAD - World Investment Report 2019

Figura 4. Flukset Hyrëse të IHD-ve në Vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: World Development Indicators

Por, IHD në Shqipëri kanë vijuar një trend të lehtë rënës duke filluar nga viti 2013 (9,8% të PBB) duke arritur në 8% të PBB në fund të vitit 2018. Fluksi i IHD-ve në Shqipëri¹⁶, në fund të vitit 2018 u përqendrua kryesisht në energji elektrike, gaz dhe furnizim me ujë (46% të totalit) dhe industrinë nxjerrëse (17% të totalit).

Ndërkohë, në vendet e rajonit panorama e shpërndarjes sektoriale të IHD-ve paraqitet më ndryshe. Në Serbi, sektorët kryesorë të IHD-ve janë sektori financiar dhe industria përpunuese si automotive, elektrike, ushqimore dhe tekstile. Në Maqedoninë e Veriut, vitet e fundit IHD-të janë në sektorin e industrisë automotive; në Bosnjë dhe Hercegovinë, sektorët me fluksin më të lartë janë industria, bankat dhe telekomunikacioni; në Mal të Zi, sektori mbizotërues është turizmi. Bazuar në të dhënat e publikuara nga UNCTAD, krahasuar me vendet e rajonit që nga 2010 Shqipëria ka tërhequr një numër më të ulët të projekteve “greenfield”¹⁷.

16 www.bankofalbania.org

17 Një investim “greenfield” i referohet një lloji të investimeve të huaja direkte (IHD) ku një kompani investon në një vend të huaj duke ndërtuar objekte të reja nga e para p.sh. fabrika prodhimi, zyra shitje, etj.

Si një ekonomi e vogël në tranzicion, ekonomia shqiptare ka bërë progres të dukshëm në ecurinë e tregtisë së jashtme. Sipas vlerësimeve të raportit të BB, “*Strengthening Albania’s Trade Competitiveness*” (qershor 2019), Shqipëria ka tejkaluar rritjen vjetore botërore të tregtisë dhe ka arritur deri në 11% rritje mesatare vjetore¹⁸. Sfida e Shqipërisë në terma të eksporteve mbetet shporta e mallrave të eksportit e përqendruar drejt produkteve me vlerë të shtuar të ulët¹⁹. Në lidhje me strukturën e të mirave të eksportuara sipas nivelit të teknologjisë²⁰, Shqipëria paraqet diferencë me vendet e tjera, ku 90% e të mirave të eksportuara janë kryesisht produkte që kërkojnë fuqi punëtore të lartë dhe burime natyrore. Mesatarja e Ballkanit për këtë kategori produktesh është në 50% të të mirave të eksportuara. Kjo përbën një sfidë për konkurrueshmërinë e vendit kundrejt rajonit, për të tërhequr industri me nivel më të lartë teknologjik dhe për të rritur vlerën e produkteve për treg të brendshëm dhe eksport.

18 Rritja vjetore e totalit të eksporteve dhe importeve

19 Strengthening Albania’s Trade Competitiveness, Banka Botërore, Qershor 2019

20 Sanfey, Milatovic, Kresic, 2016

ORIENTIMI NDAJ POTENCIALEVE TË RRITJES EKONOMIKE

1. VIZIONI QEVERISËS

Nga analiza e dokumentave kryesorë që udhëheqin politikën e vendit²¹, vihet re orientimi i politikave të qeverisë tek industrializimi i vendit për të siguruar rritje të qëndrueshme. Sektorët që do të mbështeten, sipas dokumentave strategjikë²² janë “*energjitik dhe burimet natyrore*”, “*hidrokarburef*”, “*industria minerare*”, “*bujqësia*”, “*turizmi*”, “*kultura dhe turizmi kulturor*”. Brenda kornizave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, janë hartuar edhe strategjitë përkatëse sipas sektorëve prioritarë ku ndër të tjera përmendim:

» “*Strategjia për Zhvillim dhe Biznesit dhe Inves-*

21 Qeveria shqiptare në programin e saj qeverisës thekson se “një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet politikave ekonomike e financiare që stimulojnë investimet në drejtim të rritjes dhe të zgjerimit të industrializimit nëpërmjet shtimit të aktiviteteve me karakter industrial. Kjo do të synojë rritjen e kapaciteteve prodhuese e përpunuese të sektorit industrial në Shqipëri. Përqendrimi i vëmendjes drejt rritjes së nivelit të industrializimit të lehtë të vendit përbën një nga prioritetet e qeverisjes sonë në mandatin 2017-2021.” – Programi qeverisës 2017 – 2021

22 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Biznesit 2014-2020

timeve 2014-2020” është dokumenti kryesor ku mund të identifikohen politikat kombëtare dhe implementimi i tyre në kuadër të zhvillimit të biznesit dhe rritjes së investimeve në Shqipëri.

- » “*Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020*”, me objektiv kryesor përcaktimin e kuadrit strategjik për trajtimin e sfidave me të cilat përballlet sektori i bujqësisë dhe agropërpunimit si edhe zhvillimi i zonave rurale në mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale.
- » “*Strategjia e Axtendës Dixhitale 2015-2020*”, synon drejtimin më të koordinuar dhe më efikas të investimeve në sektorin e teknologjive të informacionit dhe komunikimeve, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarin dhe përmirësimin e jetesës.
- » “*Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Informacionin 2017-2022*” e cila përcakton politikën, vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjike të zhvillimit të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit.
- » “*Strategjia Kombëtare e Transportit 2018-*

2021", me qëllimin kryesor zhvillimin e një sektori eficient transporti i integruar në rajon e më gjërë në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

- » "Strategjia kombëtare e energjisë" 2018-2030 në të cilën janë përfshirë ndryshimet e nevojshme që duhet të ndodhin për të rritur sigurinë e furnizimit me burime energjitike dhe optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
- » "Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023" me vizionin e transformimit të Shqipërisë në një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, me synim zhvillimin e qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit.

Sikurse vërehet më lart, një pjesë e strategjive kombëtare janë në përfundim të afateve të tyre, dhe ndoshta është momenti kritik për të analizuar impaktin dhe hapur debatin mbi vizionin e vendimmarrjes në 5-10 vitet që vijnë dhe modelin e ekonomisë së vendit. *Momenti bëhet më strategjik duke konsideruar edhe perspektivën e afërt të integrimit të vendit në BE dhe harmonizimin me "acquis communautaire".*

2. POLITIKA FISKALE

Në kontekstin makroekonomik, Shqipëria ka ndërmarrë vitet e fundit masa konkrete në kujdesin ndaj parashikimit të treguesve kryesorë ekonomikë, reduktimin e borxhit publik, kontrollin e kontratave PPP duke kontribuar në rritjen e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe mundësinë e hedhjes së kapitalit në treg.

Rregulli fiskal i miratuar në vitin 2016²³, përcak-

23 Ligji 54/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në

ton uljen e borxhit publik deri në masën 45% të PBB. Gjithashtu, bazuar në të njëjtin rregull të ardhurat korrente të vendit do të përdoren për përbalimin e shpenzimeve korrente dhe më pas në financimin e investimeve publike. I njëjti rregull përpiket të kontrollojë edhe përdorimin e kujdesshëm të parave publike përsa u përket kontratave PPP²⁴. Gjithashtu, ndryshimet e politikave fiskale *me efekte në të ardhurat tatimore* janë parashikuar të ndodhin vetëm një herë në vit dhe jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i vitit buxhetor.

Paketat e fundit fiskale kanë bërë të mundur uljen e taksimit të kapitalit duke ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit. Ulja e tatimit të dividendit nga 15% në 8% si një masë kundër tatimit të dyfishtë ka qenë e mirëpritur nga biznesi pasi ndihmon në hedhjen e kapitalit në treg duke i dhënë shtysë rritjes së konsumit dhe investimeve në ekonomi. Gjithashtu, shtrirja e bazës së taksueshme të pagës në 150.000 lek do të ndihmojë në *reduktimin e kostos së punës* për mbajtjen e punëtorëve të kualifikuar.

Përsa i përket, masave fiskale në nxitjen e investimeve në teknologji, legjislacioni shqiptar përfshin *përrjashtimet nga TVSH-ja në furnizimin me makineri dhe pajisje bujqësore, makineri për punim aktiv dhe agro-biznes*. Një masë që duket se ka dhënë kontributin e saj në rritjen e importit të makineri pajisjeve në vend, por edhe në rritjen e eksporteve shqiptare në lidhje me produktet e agro-përpunimit²⁵. Qeveria ka incentivuar edhe sektorin TIK, duke ulur *tatim fitimit nga 15%*

Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

24 Neni 4/2 Ligji 58/2016 "Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor".

25 INSTAT (2019), Tregtia e Jashtme


në 5% për kompanitë që ushtrojnë aktivitet në sektorin e prodhimit/zhvillimit të programeve kompjuterike. Sipas INSTAT, gjatë vitit 2018 në vend janë krijuar 742 kompani të reja në fushën e informacionit dhe komunikimit, kryesisht kompani të vogla deri në 9 punëtorë.

Incentivat e ndërmarra në fushën e turizmit në nxitje të sektorit të agro-turizmit, kanë sjellë gjithashtu rritjen e krijimit të kompanive të reja gjatë vitit 2018 me 3.120 të tilla duke ndikuar edhe në rritjen e fuqisë punëtore.

Për të stimuluar debatin, midis politikave dhe

impaktit të tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, grafikët më poshtë japin ecurinë e formimit të kapitalit bruto fiks në makineri dhe pajisje, bujqësi dhe programe kompjuterike dhe databaza si indikatorë të investimeve në ekonomi. Përgjithësisht trendi në sektorin e bujqësisë është në rënie duke treguar kontributin negativ të këtij sektori në treguesin e përgjithshëm të Formimit të Kapitalit Bruto Fiks (FKBF), ndërkohë në programe kompjuterike dhe databaza, trendi është në rritje duke treguar përparësinë që ka marrë ky sektor në investimet në ekonomi.

Figura 7. Formimi i Kapitalit Bruto Fiks (rritja në %)



Burimi: INSTAT

Theksojmë gjithashtu edhe incentiva të dedikuara sektoriale me synim stimulimin e investimeve. Në vijim të incentivave ligjore dhe rregullatore të ofruara për investitorët strategjikë (procedura administrative me një ndalesë përmes AIDA-s me procedurë speciale/të asistuar ofruar për investitorët) ose incentiva financiare për investitorët e mundshëm në zonat e lira ekonomike (TEDA) gjatë 2015-2016 dhe incentiva shtesë aty ku parashikohen. Kjo konsiston kryesisht në incentiva fiskale (lehtësime tatimore) për strukturat e akomodimit të turizmit/agroturizmit, të cilat krahasuar me vendet e tjera duken më agresive. Një përmbledhje e hollësishme e incentivave të tillë është përgatitur nga Sekretariati kur u analizua informaliteti në sektorin e Turizmit²⁶.

Për qëllime të analizës, Sekretariati ka përditësuar matricën krahasuese (përgatitur në prill 2017 në bashkëpunim me AIDA).

- » Ajo që është e përbashkët për shumicën e vendeve, pjesë e Matricës së përditësuar në Shtojcën 2, është se ata kanë miratuar një taksë progresive mbi të ardhurat dhe norma të ndryshme të TVSH-së në varësi të sektorëve.
- » Për më tepër, Shqipëria aplikon një normë të reduktuar të tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, zbaton kufirin më të ulët të qarkullimit minimal për qëllime të TVSH-së prej 2 mln lekësh dhe ka zbatuar një paketë masash fiskale për turizmin dhe agroturizmin në përpjekje për të nxitur ndërtimin e strukturave akomoduese.
- » Vende si Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë më agresive drejt targetimit të investitorëve në sektorë të tjerë nëpërmjet zonave të lira ekonomike kombëtare dhe rajonale dhe politikave të shpërblimit të drejtpërdrejt për çdo vend të ri pune të hapur në vend.

26 *Mbi Formalizimin në Turizëm* (15 tetor 2018) - Mbledhje XXIV e KI

- » Theksojmë, se ndërsa taksimi njihet si faktor i rëndësishëm në vendimet e kompanive për të investuar, nuk është përcaktori kryesor²⁷. Investimet e Huaja Direkte tërhiqen nga ato vende që ofrojnë hyrje në tregje dhe mundësi fitimi; kornizë ligjore dhe rregullatore të parashikueshme dhe jo-diskriminuese, stabilitet makroekonomik; forcë punëtore të përgjegjshme dhe të aftë dhe infrastrukturë të zhvilluar mirë. Janë të gjithë këta faktorë që në tërësinë e tyre ndikojnë në përfitimin afatgjatë të një projekti.

3. DINAMIKAT E KUADRIT LIGJOR NË FUSHËN E INVESTIMEVE

Sekretariati i KI ka përgatitur edhe më herët²⁸ një analizë mbi kuadrin ligjor të zbatueshëm në fushën e investimeve. Nga kjo analizë dhe si kurse është pranuar edhe në KI konkludohet se Shqipëria ka adoptuar prej kohësh një legjislacion liberal, veçanërisht sa i takon investimeve të huaja në vend, të mbështetur në parimin e mos-diskriminimit ndërmjet investitorëve vendas dhe të huaj. Shkurtimisht:

a) *Ligjet bazë të cilat adresojnë çështje që lidhen me investimet janë:*

- » Ligji nr. 7764/1993 “Për Investimet e Huaja” i ndryshuar me Ligjin nr. 10316 datë 26.09.2010 dhe Ligjin nr. 46/2017 datë 13.04.2017.
- » Ligji nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike”
- » Ligji nr. 9789/2007 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Zonave Ekonomike” ndryshuar me Ligjin nr. 54/2015 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zh-

27 *Tax Effects on Foreign Direct Investment, OECD 2018*

28 *Mbi Kuadrin Ligjor të Investimeve* (18 qershor 2018) - Mbledhja XIII e KI

- villimit Ekonomik” i cili parashikoi incentiva fiskale konkrete për veprimtarinë ekonomike të industrive të reja, teknologjive novatore, teknologjive të informacionit, industrive që përmbushin standardet ndërkombëtare të eliminimit të ndotjes, industrive efçente në përdorimin e energjisë, si dhe industrive me produktivitet të lartë në raport me punonjësit.
- » Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar me Ligjin nr. 88/2014 dhe 77/2015 objekt i diskutimeve së fundmi në lidhje me kufizimin e PPP për ofertat e pakërkuara.

b) *Draft - Ligji i Unifikuar i Investimeve*

Prej më shumë se 2 vitesh, po diskutohet për përgatitjen e një ligji të unifikuar të investimeve²⁹ i cili mendohet të përfundohet brenda 2019 së bashku me aktet nën-ligjore përkatëse, për përmirësimin e besimit të investitorëve duke krijuar mekanizma për ruajtjen, mbajtjen e investimeve dhe trajtimin e ankesave të tyre (*investor grievance mechanisms*) dhe për të nxitur përmirësimin e kuadrit institucional. Disa nga komentet dhe çështjet më kryesore që sugjerohet të mbahen në konsideratë lidhen me sa më poshtë vijon:

(1) *Qartësimi i objektivave strategjike dhe politikave kombëtare që orientojnë investimet:*

- » Investitorët, pavarësisht se marrin rreziqe në këmbim të fitimit, e konsiderojnë qëndrueshmërinë dhe qartësinë e prioriteteve strategjike si një nga nxitësit kryesorë në vendimmarrje. Kështu nga konsultimet rezultoi se bizneset kërkojnë një vëmendje të qëndrueshme dhe të qartë ndaj politikave

29 *Objektiv i vendosur me Udhërrëfyesin e Politikës së Investimeve të Qeverisë Shqiptare miratuar me VKM nr. 579 datë 03.08.2016.*

ekonomike tek sektorët/aktivitetet (p.sh. shërbimet) që janë në koherencë me avantazhet konkurruese të Shqipërisë (p.sh. krah i lirë i punës), burimet natyrore dhe infrastruktura (përfshirë transportin, energjinë dhe komunikimet elektronike).

- » Orientimi i investimeve publike në funksion të konkurrueshmërisë duke përmirësuar infrastrukturën, institucionet dhe shërbimet ndaj biznesit do të forconte ndikimin e reformave legjislativë në klimën e investimeve.

(2) *Administrata dhe Institucionet*

- » Ridimensionimi i administratës që të garantojë zbatimin e përgjegjshëm dhe efektiv të parimeve të sanksionuara në ligje;
- » Rritja e kapaciteteve të organeve rregullatore veçanërisht në industri specifike si komunikime elektronike, hidrokarbure, shërbimet financiare dhe ato të sigurimeve;
- » Lufta ndaj korrupsionit dhe praktikave institucionale të cilat kufizojnë konkurrencën e ndershme dhe hapjen e tregjeve;
- » Institucionet mbështetëse të investitorëve dhe strukturat përgjegjëse për trajtimin e ankesave të tyre.

(3) *Aksesi, transparenca dhe vlerësimi i impaktit të incentivave në investime*

- » Bërja publike e analizave të impaktit të Ligjit 55/2015 “Për Investimet Strategjike” në thithjen e investimeve dhe statusi i këtyre investimeve;


Në fazë diskutimi janë edhe miratimi i projektligjit “Për Krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare” i cili ka qenë objekt diskutimesh, komentesh dhe rishikimesh edhe nga partnerët për zhvillim të Shqipërisë. Ky ligj vlerësohet se do t'i japë një shtysë projekteve të TEDA/Zonave të Lira Ekonomike me palë zhvilluese/bashkëzhvilluese shtetin.

GJETJE

Bazuar në sa më lart, si edhe në konsultimet direkte me përfaqësues të biznesit mbi atë se cila mund të jetë qasja strategjike e vendit kundrejt potencialit (të fokusuar drejt sektorëve dhe

klimës) të investimeve si edhe sfidave aktuale (kombëtare, rajonale apo globale), për të siguruar rritje të qëndrueshme, Sekretariati ka evidentuar gjetjet më kryesore në disa nivele si më poshtë vijon:

Figura 8. Perceptimi i sektorit privat mbi faktorët kryesorë që duhet të përmirësohen



Burimi: Përpunim i Sekretariatit të KI nga konsultimet me biznesin (shtator 2019)

1. Vështirësia në fokusimin e politikave sipas vizionit të deklaruar

Pavarësisht ekzistencës së dokumentave strategjikë të cilët përcaktojnë drejtimet e politikave, në praktikë evidentohet se *fokusi nuk është gjithmonë i qëndrueshëm në kohë dhe në projektet mbështetëse*. Kështu, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit³⁰. Ajo kombinon axhendën zhvillimore me proceset integruese të vendit, *duke përmbledhur vizionin, prioritetet dhe objektivat madhore kombëtare*. Bazuar në vizionin e përcaktuar në SKZHI³¹, janë zhvilluar strategjitë përkatëse sipas sektorëve të identifikuar në këtë strategji me synimin e arritjes së objektivave madhore³². Theksojmë se p.sh. përzgjedhja e sektorit të turizmit si prioritet e potencial për rritje të qëndrueshme të vendit, u iniciua me miratimin e SKZHI në vitin 2014, dhe u përfshi edhe në Ligjin e Investimeve Strategjike (2015) apo edhe incentivat fiskale të 2018. Ndërkohë strategjia e sektorit u miratua vetëm në qershor 2019. Kjo hapësirë kohore, e shoqëruar edhe me ndryshimet politike dhe institucionale, konsiderohet se ka influencuar në potencialin e investimeve të sektorit e sigurisht edhe në *fokusin e ndërhyrjeve*. Një shembull tjetër, është edhe deklarimi i projekteve të rëndësishme infrastrukturore për zhvillimin e turizmit si ndërtimi i aeroportit të Vlorës, porteve, infrastrukturës rrugore drejt zonave turistike që përbëjnë një

stimul shumë të rëndësishëm për investitorët, por sfida jo të vogla lidhen me progresin dhe afatet e realizimit të tyre në kohë.

Ndërkohë, theksojmë se p.sh. paketa fason (po t'i referohemi shifrave dhe procesit), mund të konsiderohet si një histori pozitive bashkëveprimit shtet – biznes. Bazuar në vlerësimet e INSTAT³³, numri i ndërmarrjeve në aktivitetin përpunues është rritur me 29%, numri i të punësuarve me 37% dhe vlera e shtuar në ekonomi ka rritje 46%. Masat e marra në bashkëpunim me biznesin dhe përqendrimi i vëmendjes së shtetit në realizimin e këtyre masave e shndërruan sektorin e fasonëve në promotor të rritjes së punësimit, rritjes së eksporteve në “tekstile e këpucë” dhe tërheqjen e më shumë investitorëve brenda sektorit. Nga viti 2014 (viti i prezantimit të paketës), eksportet në grup-mallin “tekstile dhe këpucë” janë rritur mesatarisht me 14% në vit dhe ky grup mall e ka rritur peshën e tij në strukturën e eksporteve nga 28% në vitin 2013 në 44% në vitin 2016, dy vjet pas aplikimit të paketës së propozuar.

2. Mungesa e të dhënave apo edhe e vlerësimeve të impaktit të strategjive si p.sh. Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve

Theksojmë rëndësinë e raporteve të monitorimit si instrumenta të rëndësishme të matjes së progresit, si p.sh. referuar raportit të fundit të monitorimit (përgatitur nga GIZ) janë realizuar 70% e aktiviteteve të strategjisë biznesit dhe investimeve. Por për të gjykuar realisht mbi progresin e arritur, sfidat dhe për të ndërtuar vizionin, gjykojmë të rëndësishme analizën e impaktit dhe të indikatorëve të

30 <https://www.kryeministria.al/strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-2015-2020/>

31 Rreth 37 strategji ndërsektoriale dhe programe kombëtare bazohen tek SKZHI

32 (1) Rritja nëpërmjet stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, (2) rritja nëpërmjet shtimit të konkurrueshmërisë, (3) investimi në kapitalin njerëzor dhe kohëzision social, (4) rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit territorial.

33 INSTAT (2018), Rregjistri i Ndërmarrjeve


performancës. Ndërkohë, ndjekja e ecurisë së treguesve specifike do të ndihmonte saktësimin dhe marrjen e masave të duhura për të ndihmuar arritjen e objektivave sipas komponentëve të caktuar.

3. Disponibiliteti dhe cilësia e fuqisë punëtore kundrejt kërkesave të tregut - sfida kryesore e së ardhmes

Aktualisht, nga konsultimet e Sekretariatit me investitorët, rezulton si faktor shumë i rëndësishëm në vendimarrjen për të investuar, disponueshmëria dhe cilësia e fuqisë punëtore. Kjo problematikë, është trajtuar tashmë nga Këshilli i Investimeve që në shkurt të 2017.

Figura 9. Perceptimi i sektorit privat mbi sfidën e tij të ardhshme

Cila është sfida e të ardhmes për biznesin në Shqipëri?



* "Tjetër" përfshin prona, certifikimi i produkteve, sistemi dhe institucionet, klientelizmi
Burimi: Përpunim i Sekretariatit të KI nga konsultimet me biznesin (shtator 2019)

Ndërkohë, theksojmë edhe faktin se sipas të dhënave të publikuara³⁴, Shqipëria renditet në mesin e 20 vendeve të para (e 17 në publikim e vitit 2016) për emigrim. **Problematika paraqitet tepër e rëndësishme dhe kërkon ndërhyrje të integruar dhe emergjente në disa nivele. Theksojmë progresin në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator dhe përqendrimit tek arsimi profesional (Ligji mbi nxitjen e punësimit, mars 2019/Ligji nr. 15/2017 "Mbi arsimin profesional në Republikën e Shqipërisë"/disa VKM të miratuara gjatë vitit 2018) por rezultatet duhet të monitorohen.**

4. **Problematikat në lidhje me të drejtën e pronësisë që i referohen titujve të tokës dhe administrimit të tokës³⁵ janë gjithashtu një pengesë e madhe për tërheqjen e investimeve në sektorët strategjikë, veçanërisht në bujqësi dhe mbeten një pengesë kryesore për përmirësimin e mjedisit të investimeve në Shqipëri. Përmirësimet e parashikimit si rrjedhojë e zhvillimeve më të fundit të një kuadri të ri ligjor dhe institucional për Kadastrën mbeten ende për t'u vlerësuar.**

Sekretariati i KI e ka trajtuar këtë çështje duke ofruar rekomandime përkatëse (Mbledhje XVI e KI, maj 2019). Shkurtimisht nënvizohen se a) nuk ka ende një regjistër unik të plotë dhe të konsoliduar të pronave të paluajtshme, gjë që ka ndikuar në mënyrë të veçantë në vendimin e in-

³⁴ UNDP, https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/Brain_Gain%20web.pdf.

³⁵ Çështje të identifikuar në mbledhjen XVI të KI.

vestitorëve potencialë në bujqësi dhe turizëm³⁶, b) Megjithëse Ligji nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike" sipas nenit 31 parashikon krijimin e Fondit për Mbështetje Strategjike të Fondit të Pasurive të Paluajtshme³⁷, deri më sot nuk ka ende një regjistër gjithëpërfshirës të këtyre pronave, statusit dhe kategorisë së tyre, c) kufizimet në lidhje me të drejtën e pronësisë janë gjithashtu një problematikë e identifikuar nga BE³⁸, investitorët dhe ekspertët e huaj gjatë fazave të konsultimit për projektligjin e ri të investimeve³⁹, si një kufizim formal për investitorët e huaj.⁴⁰

5. **Çështje të ndryshme ligjore dhe rregullatore në klimën e Investimeve** janë trajtuar tashmë nga KI, shkurtimisht të përmbledhura në tabelën vijuese:

Sistemi gjyqësor jo funksional për t'u përgjigjur siç duhet kërkesave të biznesit për zgjidhje të shpejtë dhe të drejtë të mosmarrëveshjeve.

Janë me mijëra kërkesa për seancë gjyqësore në Gjykatat Administrative të cilat prej vitesh tani kanë dështuar në misionin e tyre që nga themelimi për zgjidhjen e çështjeve brenda 60 ditësh. Më shumë se 30.000

³⁶ EU Progress Report 2019.

³⁷ Me prona shtetërore nga institucionet qendrore ose bashkitë dhe aktet nënligjore përkatëse që adresojnë procedurat dhe modalitetet për pjesëmarrjen e shtetit në investime strategjike dhe funksionimin e regjistrat të fondeve të pronave.

³⁸ Blerja e pasurive të patundshme nga të huajt mbetet subjekt i kufizimeve: ato nuk janë të gjitha për të marrë tokë bujqësore, pyje, livadhe dhe kullota. Dispozitat që rregullojnë blerjen e pasurive të patundshme nga të huajt mbeten të pandryshuara dhe paqartësitë mbi të drejtat e pasurive të paluajtshme vazhdojnë të dekurajojnë investimet.

³⁹ Ligji i Unifikuar i Investimeve

⁴⁰ EU Progress Report 2019

çështje janë në pritje në Gjykatën e Lartë⁴¹. Një pjesë e mirë e këtyre shifrave janë të lidhura me çështjet gjyqësore të iniciuara nga bizneset dhe investitorët drejt institucioneve të administratës publike. Mungesa e vendimeve gjyqësore përfundimtare ka penguar unifikimin e praktikave administrative ndaj bizneseve, duke lënë hapësirë për vendime arbitrare dhe diskrecionale nga administrata, duke rritur kështu pasigurinë ligjore. Në anën tjetër, mungesa e filtrit gjyqësor pengon vetë administratën drejt vetë-përmirësimit dhe rregullimit më të mirë.

Raste specifike sektoriale të pasigurisë ligjore për bizneset si rezultat i vendimeve polemike të diskutueshme

Disa raste në vend kanë treguar pasiguri ligjore të krijuara nga institucionet siç janë p.sh. sinjalet e përcjella tek investitorët potencialë në një sektor strategjik si energjia. Për shembull, një seri masash u morën nga Qeveria Shqiptare, autoriteti rregullator (ERE) dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) që e bënë të vështirë veprimtarinë operacionale të projekteve të vogla të gjenerimit të energjisë hidrocentrale (HEC) në Shqipëri (për shkak të vendimeve të pazakonta të ERE⁴² duke ulur çmimin e energjisë elektrike që KESH u jep hidrocentraleve të vegjël deri në 15 megavat, duke aplikuar si çmime retroaktive për vitet 2013-2014, në kundërshtim me kushtet kontraktuese të ar-

⁴¹ Procesi i vettingut në lidhje me Reformën në Drejtësi është në vazhdimësi.

⁴² Vendimi i ERE nr. 143/26.12.2014 "Për rishikimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për prodhuesit e energjisë elektrike nga HEC-et ekzistuese, me kapacitet të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 dhe 2014", dhe vendimi ERE nr. 144 "Për rishikimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për prodhuesit e energjisë elektrike nga HEC-et e reja, me kapacitet të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 dhe 2014".

rëveshjeve⁴³ të koncesionit⁴⁴.

Paqëndrueshmëria e legjislacionit. Ndryshime të shpeshta dhe ad-hoc të ligjeve dhe akteve nënligjore që përcaktojnë stabilitetin e mjedisit të biznesit.

Ndryshimet e shpeshta dhe jo të studiuar mirë me efekt afatgjatë janë identifikuar vazhdimisht nga shoqatat e bizneseve dhe kompanitë si premisa për trajtim të padrejtë. Ata kanë krijuar disi pasiguri në kontekstin e një administrate të paqëndrueshme dhe jo plotësisht profesionale për të transpozuar në mënyrë të duhur dhe në kohë vullnetin e ligjeve. Kjo është një çështje me prevalencë madhore në rastet e procedurave me ndikim financiar për bizneset.

Një shembull i kësaj është vendosja e taksës për produktet plastike me Ligjin nr. 93/2018, datë 03.12.2018, i cili më pas i është kaskaduar administratës dhe bizneseve përmes udhëzimeve vetëm në fund të shkurtit 2019 me Udhëzimin nr. 20.2.2019. Vlen të përmendet këtu që Ligji nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore”, si ligji më i rëndësishëm në lidhje me taksat, është ndryshuar 16 herë, ndërsa Udhëzimi i tij nr. 24/2018 është ndryshuar 18 herë, me ndryshime thelbësore me rregulla dhe procedura të reja dhe kohë të shkurtër zbatimi.

43 Çmimi i shitjes për HEC-et e rinj deri në 15 ME për periudhën rregullatore 2012-2014 ishte 9.3 lekë për kilovat. Me rishikimin e bërë nga ERE, çmimi i shitjes për 2013 ishte llogaritur në 9,73 lekë/kwh dhe për vitin 2014 u rillogarit në 7,95 lekë/kwh. Rillogaritja për vitin 2014, nga 9,3 lekë në 7,9 lekë, shënoi një rënie prej rreth 14% të fitimeve që HEC-et kishin përfituar nga shitja e energjisë.

44 Më 13 qershor 2017, pas disa seancave gjyqësore, Gjykata e Lartë vendosi në favor të HEC-ve të vegjël, duke përfshirë parimin e sigurisë juridike, sipas të cilit të drejtat e fituara nuk mund të jenë objekt i ndryshimeve të njëanshme nga ERE me imponimin e çmimeve më të ulëta prapavepruese. Sipas këtij vendimi, KESH sh.a duhet të paguajë 6 Mln Euro, si rezultat i një vendimi jo të konsultuar nga ERE.

6. Megjithëse legjislacioni kryesor për nxitjen e investimeve të ndryshme është miratuar dhe ka vullnet të mirë nga qeveria, janë hasur vështirësi në materializimin e legjislacionit të miratuar në masa dhe veprimtari konkrete.

Rastet e Zonave të Lira Ekonomike (TEDA) ku ende nuk janë zbatuar investime aktive, duhet të rrisin ndërgjegjësimin për më shumë fokus dhe dedikim. Ligji për TEDA⁴⁵ parashikon një seri incentivash fiskale, administrative dhe ligjore⁴⁶ me synim tërheqjen e investimeve në fushën e teknologjive të përparuara në zona të lira, sipas përcaktimeve të Kodit Doganor. Në kohën e miratimit, ky ligj ka konsideruar si një ndryshim të nevojshëm thjeshtimin e procedurave për biznesin, duke parashikuar një sërë incentivash të konsoliduar me fokus të qartë. Aktet nënligjore u miratuan në kohën e duhur dhe plotësuan të gjithë paketën e kësaj nisme⁴⁷. Megjithë përpjekjet dhe procedurat për tërheqjen e investitorëve në TEDA, që nga viti 2015 e deri më tani nuk ka asnjë TEDA të implementuar nga kompani private apo bashki, megjithëse shteti ka përgatitur dokumentacionin për TEDA Spitallë dhe TEDA Koplik. Ndërsa legjislacioni për investimet strategjike është plotësuar me aktet nënligjore përkatëse, ndikimi i tij i perceptuar do të vlerësohej shumë. Investimet janë përqendruar kryesisht në turizëm (7) dhe në bujqësi (4). Më poshtë, pajiset me një

45 Ligji nr. 9789 datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik” i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007,” “Për Krijimin dhe funksionimin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik”.

46 Neni 13 i Ligjit nr. 9789 datë 19.07.2007 përcakton 10 stimuj/lehtësim fiskal. Paragrafi 1 pika b) i nenit 13 “Lehtësitë Fiskale” të Ligjit nr. 9789, përcakton si lehtësira fiskale: “zhvilluesit dhe përdoruesit janë të liruar nga pagesa e taksës 50 përqind të fitimit mbi fitimin për 5 vitet e para nga fillimin e veprimtarisë së tyre në zonë”. Investitorët nuk e konsiderojnë këtë një garanci të plotë në kushtet e ndryshimit (rritjes) potenciale të normës së tatimit mbi fitimin e korporatave, si rezultat i ndryshimeve në paketën fiskale.

47 http://www.teda.gov.al/?page_id=690

status të projekteve siç konfirmohet nga AIDA:

- » Në total nga KIS janë aprovuar 13 projekte të investimeve strategjike, nga të cilat 8 kanë përfituar statusin e investitorit strategjik/procedurë e asistuar dhe 5 statusin e investitorit strategjik/procedurë e veçantë.
- » Sektorët – 7 projekte janë në sektorin e turizmit, 4 në sektorin e bujqësisë, 1 në sektorin e energjisë dhe 1 në sektorin e zonave me përparësi zhvillimi.
- » Në zbatim janë 7 projekte në turizëm, 2 në bujqësi dhe 1 në sektorin e zonave me përparësi zhvillimi.
- » Aktualisht, 4 projekte janë në fazë aplikimi, nga të cilat 3 në sektorin e turizmit dhe 1 në sektorin e bujqësisë.
- » Ndërkohë 15 projekte janë në fazë konsultimi, nga të cilat 5 janë në bujqësi, 6 në turizëm dhe 4 në energji.

Sipas të dhënave nga AIDA, vlera totale e investimeve të propozuara është 2.007.090.406 Eur, ndërsa vlera totale e investimeve të miratuara është 692.826.000 Eur.

7. Sektorët potencialë për investime

Në përpjekje për të debatuar mbi qasjen strategjike mbi tërheqjen e investimeve të reja, dhe sektorët që mund të konsiderohen si potenciale të vendit, nga konsultimi me bizneset, rezulton se përveç kriterëve klasike, ka edhe disa konsiderata që duhen të merren parasysh si p.sh. tërheqja ose jo e industrive që kërkojnë shumë fuqi punëtore për hir të problematikës që theksuam/kërkuam më lart, ose tërheqjen e kompanive industritë/biznese që kërkojnë investime në truall apo prona të pastra, ose qendra (*hubs*) logjistike që paraprakisht kërkojnë infrastrukturë të gatshme. Gjithashtu theksojmë potencialin e sektorit të ndërtimit, që kushtëzohet nga informaliteti (p.sh. godina të paregjistruara), por që në fakt mbart përfitime veçanërisht në rritjen e eksporteve.

Nga konsultimet mund të theksojmë se disa sektorë u prioritetizuan, si më poshtë vijon:

- a) ***Agro-përpunimi***⁴⁸: perceptohet si një sektor ku ekzistojnë potenciale për investime të reja si p.sh. investime në përpunimin e produkteve dhe fruta perime “*niche*” me vlerë të shtuar për eksport dhe për tregun vendas (*made in albania*), apo përpunimi në vend i bimëve medicinale etj. Vitet e fundit vërehet rritje e eksportit të bimëve, rrënjët, lulet dhe gjethet zbukuruese, çaji dhe erëzat si edhe rritja e eksporteve në produktet bujqësore të përpunuara të tilla si përpunimet e zarzavateve edhe frutave.
- b) ***Turizmi***⁴⁹ - Perceptimi se sektori i turizmit është potencial për të mbështetur rritje të qëndrueshme ekonomike për Shqipërinë mbështetet edhe nga të dhënat e fundit zyrtare. Përgjatë vitit 2017⁵⁰, sektori i turizmit regjistroi një kontribut direkt 8,5% të PBB, punësoi rreth 7,7% të forcës së punës në Shqipëri, mbuloi 7,5% të Investimeve në vend dhe numri i sipërmarrjeve u rrit me 26%. Turizmi përbën 11% të të gjithë aktiviteteve ekonomike në Shqipëri. Ndërkohë, sfida e turizmit kundrejt arritjes së potencialit që përfaqëson kushtëzohet nga progresi i infrastrukturës, ruajtja e eko-sistemeve, kapacitetet akomoduese, cilësia e shërbimeve, oferta dhe produkti turistik. Theksojmë se këta faktorë kanë frenuar disi zhvillimin e qëndrueshëm dhe konsistent të turizmit në Shqipëri, duke i lënë vend një zhvillimi të pakontrolluar e kaotik që faktikisht e ka mbajtur në këmbë këtë industri, por duke rrezikuar ndoshta qëndrueshmërinë e tij në terma afat-gjatë.
- c) ***Burimet Natyrore*** – Ndërsa interesi mbetet i konsiderueshëm për sektorin, veçanërisht nga investitorët e huaj, përsëri modeli dhe mbikëq-

48 Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, përcakton drejtimet kryesore të mbështetjes së sektorit nga ana e qeverisë shqiptare dhe disa incentiva fiskale janë miratuar në mbështetje të saj.

49 Informacion i detajuar mbi sektorin jepet në shtojcë.

50 Sipas Raportit të Impaktit Ekonomik të Udhëtimit dhe Turizmit 2018, të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (ETTC).

yrja e mirë e sektorit, veçanërisht për hidrokarburet mbetet një sfidë e vërtetë. Më poshtë është dhënë një përmbledhje e shkurtër e kapaciteteve në fushën e burimeve të rinovueshme dhe hidrokarbure⁵¹.

BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË

1. Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm për **energji nga Uji**, ku rreth 35% e tij shfrytëzohet. Ka rreth 540 HEC-e (527 HEC-e të vegjël deri në 2 MW) që përfaqësojnë 31% të parashikimit të gjenerimit, që është vetëm 43% e konsumit të energjisë elektrike e parashikuar në vitin 2020. Qeveria është e angazhuar për mbështetje të politikave të rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme, kryesisht hidro, diellore dhe erës⁵². Vendi është i ekspozuar në një shkallë të konsiderueshme ndaj rrezikut të pasigurisë së furnizimit, për shkak të ndryshimeve të kushteve hidrologjike dhe mosdiversifikimit të burimeve. Objektivi kombëtar i prodhimit të energjisë në Shqipëri nga burimet e rinovueshme të energjisë në raport me konsumin final bruto është 38 përqind në vitin 2020⁵³. Edhe pse është adoptuar një kuadër ligjor i ri që mbështet vizionin, ai ende nuk është plotësuar më kuadrin nën-ligjor. Ligji Nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme” u miratua në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe Direktivën nr. 2009/28/ EC “Për Burimet e Rinovueshme të Energjisë”.

Ky ligj parashikon “masa mbështetëse”⁵⁴ si një angazhim i drejtpërdrejt i Qeverisë në mënyrë që të arrihet objektivi në prodhimin dhe përdorimin e energjisë së prodhuar nga burime të rinovueshme.

2. **Energji nga Era. Tridhjetë kompani kanë aplikuar për parqet Eolike (Energji nga era)**⁵⁵ - por ende nuk ka asnjë në fazë prodhimi. Energjia e erës përbën një mundësi potenciale për prodhimin e energjisë në Shqipëri. Problemi kryesor i ndërtimit të këtyre parqeve në Shqipëri është mungesa e matjeve të njëpasnjëshme të shpejtësisë dhe kohëzgjatjes së erës që do të krijonin një panoramë më të qartë për investitorët e interesuar lidhur me potencialet.
3. **Fotovoltaikët.** Gjatë konsultimeve u identifikua interesi i investitorëve potencialë për sektorin. **Aktualisht ka 11 kontrata të lidhura për prodhimin e energjisë nga fotovoltaikët (panelet diellore) ndërsa numri i aplikimeve është më i lartë.** Rreth 10 muaj pasi u shpall fituesi i ankandit për ndërtimin e termocentralit fotovoltaik Akernia në Vlorë, palët (Investitori dhe MIE) ende nuk kanë nënshkruar një kontratë që do t'i hapte rrugën një prej investimeve më të rëndësishme energjetike në vend. Ekziston interesi i investitorëve në tregun e energjisë për të qenë pjesë e procedurave të mundshme për ndërtimin e fotovoltaikëve në kuadër të një procesi transparent i cili le kohë të arsyeshme për përgatitjen e planeve të investimeve dhe të konsoliduara të biznesit. Megjithatë duket se kërkesat nga ana e investitorëve janë të fokusuara drejt procedurave që mundësojnë një çmim fiks për blerjen e energjisë së prodhuar nga fotovoltaikët nga ana e Shtetit dhe rrjedhimisht një risk të vogël.

⁵⁴ Mbështetje me tarifa të rregulluara (feed-in-tariff) dhe CoD (Feed-in-premium).

⁵⁵ Plani Kombëtar i Konsoliduar i Veprimt.

⁵¹ Informacion i detajuar mbi sektorin jepet në shtojcë.

⁵² Strategjia e Energjisë 2018-2030 e miratuar me VKM nr. 480, datë 31.07.2018. Objektivat në fushën e energjisë konsistojnë në përparësitë e mëposhtme. (1) shfrytëzimi i burimeve të energjisë; (2) diversifikimi i energjisë; (3) rritja e konkurrencës dhe (4) mbrojtja e mjedisit.

⁵³ Ligji nr. 7/2017 “Për nxitjet për përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme” dhe Planit Kombëtar i Veprimt i Konsoliduar.

Në mënyrë të përmbledhur, nga konsultimet, mund të konkludohet se sektori konsiderohet i rëndësishëm për investitorët e mundshëm, parësish se përparimi i tij lidhet - me masa të mëtejshme, siç është liberalizimi i tregut (Bursa e Energjisë), modelet e çmimeve/metodologjia dhe toka në dispozicion për investime të tilla.

4. **Hidrokarbure**⁵⁶. Sektori i naftës në Shqipëri konsiderohet relativisht i vogël sipas standardeve ndërkombëtare, por është i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë e cila ka ende rezerva të mëdha të pazbuluara të naftës. Ndërmarrja shtetërore e naftës, Albpetrol, vlerëson se rezervat gjeologjike të naftës së papërpunuar janë rreth 437 milion ton dhe rezervat totale të naftës bruto janë rreth 46,9 milion ton, rezervat e gazit natyror janë rreth 5,7 billion m3N. Eksplorimi dhe nxjerrja e burimeve të tilla është e kushtueshme (duke kërkuar kështu investitorë të rëndësishëm dhe seriozë), fuqi punëtore të kualifikuar dhe një formulë të kombinuar që optimizon sasinë e nxjerrë, të ardhurat për buxhetin e shtetit dhe fitimet për kompanitë. Sektori është thelbësor për ekonominë, pasi është një nga kontribuesit kryesorë në eksportet shqiptare. Gjithashtu, sektori privat është mjaft unik në fushën e tij të operimit dhe potencialit. Kjo është arsyeja pse është një moment unik që vizioni i sektorit të përditësohet dhe të harmonizohet me institucionet përkatëse shtetërore, duke synuar të përmirësojë nivelin e tyre si profesionalisht ashtu edhe financiarisht.
5. **Dixhitalizimi.** Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri ka shënuar progres në terma të liberalizimit të tregut, zgjerimit të përdorimit të internetit, përmirësimet në shërbimet publike elektronike dhe në kuadrin e hartimit të strategjisë mbi Axiendën Dixhitale. Në parim, qeverisja krijon parakushtet duke ndërtuar strategjinë

dhe saktësuar vizionin për dixhitalizimin e ekonomisë, koordinuar donatorët dhe lehtësuar ngritjen e fondeve. BE me strategjinë e saj të dixhitalizimit dhe novacionit ka përgatitur dhe një strategji të veçantë për vendet e Ballkanit Perëndimor ku saktësohen shtyllat e ndërhyrjeve (REA MAP). Ndërkohë, një plan për internetin “broadband” pritet të përfundojë brenda prillit të 2020.

Aktualisht, sektori aktualisht përballet me disa problematika si mungesa e një institucioni përgjegjës koordinues dhe politikëbërës në nivel qendror për inovacionin dhe dixhitalizimin. Ndërkohë, theksojmë nivelin e rritur të përdorimit të internetit në Shqipëri çdo vit me 10-15%, por depërtimi i *broadband* mbetet në nivele të ulëta afërsisht 38% të familjeve të lidhura me internet. Ndërkohë, duke qenë se sektori është në zhvillim, por aktualisht kemi largim kapacitetesh drejt vendeve të zhvilluara, mbetet sfidë përgatitja e specialistëve të fushës dhe edukimi i vazhdueshëm i të rinjve (profesional dhe universitar) në mënyrë që të zvogëlohet hendeku dixhital (zonat rurale përbëjnë 40% të popullsisë, por vetëm 1% nga kjo është e lidhur me internet).

6. **TEDA.** Megjithëse legjislati në këtë fushë konsiderohet i kompletuar, nuk ka ndonjë industri aktive të lehtë që funksionon në zonat e lira ekonomike, duke qenë kështu një mundësi e jashtëzakonshme për investitorët e rinj (ju lutemi referojuni pikës 7 më lart). Paketa e incentivave të ofruara (ligjore, administrative dhe fiskale) përbën një bazë solide, e cila duhet të shoqërohet me investime në infrastrukturë nga shteti. Nga konsultimet direkte, na rezulton se aktualisht ka interes nga aktorë të ndryshëm në sektorin e përpunimit (p.sh. sektorë si agro, gjysëm produkte të gatshme, apo edhe të teknologjive të informacionit dhe dixhitalizimit, etj.) për të shfrytëzuar potencialet që ofrojnë zonat e lira ekonomike.

⁵⁶ Informacion i detajuar për sektorin administrohet dhe publikohet në [faqen zyrtare të internetit](#) të AKBN.

SUGJERIME

Në përpjekje për të nxitur debatin mbi stimulimin e investimeve në vend, si nga pikëpamja strategjike ashtu edhe nga pikëpamja sektoriale më poshtë përmendim disa konsiderata. A duhet nje qasje e re apo duhet vazhduar me të njëjtin model të strategjisë aktuale? Si e duam ne ekonominë tonë në 5-10 vitet që vijnë? Cili duhet të jetë fokusi dhe si duhet vepruar për të stimuluar investitorët aktuale për të ri-investuar në vend por edhe për të tërhequr investitorët e rinj? Si ekonomia jonë të integrohet më mirë në tregun rajonal? A mund të fokusohemi më shumë në TIK, ekonominë e gjelbër, prodhim apo energji e hidrokabure?

1. NË NIVEL STRATEGJIK

1. Iniciimi i debatit mbi modelin ekonomik të Shqipërisë dhe sektorët më prioritarë që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm e që mund të konsiderohen si “niche unike” për vendin në 10-15 vitet⁵⁷ që vijnë. Ndërkohë,

theksojmë që për vetë specifikat e ekonomisë shqiptare, a) mbështetja e SME-ve të jetë fokusi kryesor i modelit dhe i politikave mbështetëse për zhvillim të qëndrueshëm, b) mirëadministrimin fiskal si faktor thelbësor i përmirësimit të klimës së biznesit në vend.

2. Saktësimi i vizionit mbi fokusin e prioritetëve (në nivel qendror dhe vendor). Për shembull, Vizioni “Shqipëria 2030”- të përcaktohen sektorët që konsiderohen si potencialet unike dhe motorët e rritjes.

- » Konteksti specifik për vendin (transparenca dhe finalizimi i projekteve të mëdha infrastrukturore/integrimi në BE); Vendet e rajonit po konsolidojnë përpjekjet në tregun rajonal/konkurrencë agresive.
- » Qasje strategjike të tërheqjes së IHD-ve në koherencë me sektorët prioritarë dhe hartimi i një modeli ekonomik të matjes së impaktit të IHD me synim rritjen e vlerës së shtuar në vend dhe integrimin në tregun e teknologjisë dixhitale moderne.

- » Evidentohet mungesa e të dhënave koherente dhe të agreguara, kapaciteteve njerëzore e financiare për analiza të thelluara dhe matjen e impaktit. Ndaj rekomandohet krijimi i një platforme ekspertësh, me një plan konkret veprimesh që të evidentojë të dhënat e munguara, të mundësojë analiza të detajuara për impaktin e investimeve (si p.sh. opsionet e zëvendësimit apo reduktimit të importeve kryesore, opsionet e rritjes dhe diversifikimit të eksporteve, etj.), në indikatorët kryesorë ekonomike në koherencë me sektorët prioritarë.
- » Evidentimin e mundësive të targetimit p.sh. sektorit të shërbimeve (duke qënë se problematika e pronës mbetet një pengesë thelbësore për tërheqjen e investimeve serioze).
- 3. Konsolidimi dhe depolitizimi i institucioneve në koherencë me sektorët prioritarë për të siguruar “kujtesën institucionale” dhe për të arritur potencialin e zhvillimit të qëndrueshëm, p.sh. AKBN, AKU, AIDA (mungesë/zgjerim kapacitetesh), MIAP (shkrije strukture).
- 4. Monitorim dhe transparencë e bashkërendimit të Investimeve Publike (qendrore dhe vendore) në koherencë me kërkesat e strategjive të sektorëve prioritarë, për të mundësuar:
 - » optimizim të investimeve;
 - » gjenerimin e projekteve të reja (në nivel kombëtar dhe ndër-rajonal) që ndikojnë në nxitjen e investimeve dhe rritjen e aftësisë përthithëse të fondeve nga BE, WBIF, etj.
- 5. Rritja e bashkëpunimit të biznesit në nivel sektorial për të mundësuar aplikime në fonde të inovacionit dhe teknologjisë së in-

formacionit, kërkim e zhvillim në fonde të partnerëve në zhvillim si p.sh. COSME, etj.

6. Përgatitja dhe publikimi i fondit të pasurive të paluajtshme shtetërore (sipas Ligjit të Investimeve Strategjike).

2. NË NIVEL SEKTORIAL

Energji

1. Plotësimi i kuadrit ligjor mbi sektorin e energjisë së rinovueshme. (Miratimi i Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë së prodhuar nga fotovoltaiKET—prodhuesit konsumatorë, sipas Udhëzimit të MIE nr. 3, datë 20.6.2019).
2. Bërja efektive e tregut të liberalizuar të energjisë dhe Bursës së Energjisë. Investimi në rrjetin e shpërndarjes së energjisë për të përmirësuar aksesin teknik për prodhuesit vendorë të energjisë diellore dhe të erës.
3. Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës MIE-MFE-Biznes për të dialoguar mbi sfidat e sektorit në kohëncë me strategjinë e Energjisë 2018-2030.

Agropërpunimi

1. Masa nxitëse mbi de-fragmentizimin e tokës bujqësore dhe nxitjen e konkurrueshmërisë së prodhimit vendas.
2. Bërja transparente e a) informacionit dhe progresit mbi **politikat mbështetëse për sektorin e bujqësisë/agropërpunimit** nga donatorët dhe b) e ecurisë së investimeve të dhëna me kontrata shtet – private në sektor.

Dixhital

1. Fokusimi në **krijimin e kushteve rregullatore** për shërbime cilësore **në fushën e komunikimeve elektronike** (broadband/5G).
2. Plotësimi i **kuadrit rregullator** dhe promovimi i **FINTECH**.
3. Ngritja e një institucioni/platforme që të

57 Rishikim/Përgatitja e strategjive të reja që përfundojnë në 2020 (p.sh. SKZHI/SZHBII/SNZHRB/SAD, etj.).

mundësojë koordinimin ndër-sektorial e të shtyjë përpara axhendën digjitale, kërkim dhe zhvillim dhe rritjen e kapaciteteve drejt sofistikimit të biznesit (p.sh. Maqedonia e Veriut, Gjermania, Irlanda). Kjo platformë:

- » të përbëhet nga ekspertë të fushës, të adoptojë një filozofi ekosistemi ose zinxhiri vlerash (të ketë ndërveprim mes telekomunikacionit, medias, industrisë IT, infrastrukturës, përdorueshmërisë).
- » të bashkëveprojë me një rrjet aktorësh: akademi, biznes, shoqëri civile, start up, qeveri, media me fokus impaktin e digjitalizimit në Shqipëri në arsim, ekonomi, punësim, aspekte sociale, etj.

4. Krijimi i politikave konkrete incentivuese mbi arsimin profesional me fokus IT dhe aftësitë digjitale.

TEDA

1. Nga konsultimet direkte, rezulton se aktualisht ka interes nga aktivitete të ndryshme në sektorin e përpunimit (p.sh. sektorë si agro, gjysëm produkte të gatshme, apo edhe të teknologjive të informacionit dhe digjitalizimit, etj.) për të shfrytëzuar potencialet që ofrojnë zonat e lira ekonomike. Si rrjedhim do të rekomandonim bërjen aktive sa më parë të TEDA-ve për të shfrytëzuar potencialet që ato mund të ofrojnë.

Sugjerime mbi Edukimin dhe Punësimin⁵⁸

1. Qasje sektoriale mbi përshtatjen e politikave të punësimit dhe përmirësimin e aftësive të fuqisë punëtore në drejtim të sektorëve prioritarë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kjo duhet bërë përmes një kuadri të qartë regullator, por edhe përmes vendosjes së standarteve e kriterëve për zbatim, sikurse dhe përmes instrumentave incentivuese.
2. Krijimi i një formati (platforme) bashkëpunimi sistematik mes shkollave dhe bizneseve me qëllim që të krijohen konsorciume me aktorë bizneset-ofruesit e shërbimeve profesionale-shoqëri civile, zyra pune, zyra karriere, etj., që operojnë në sektorët prioritarë.
3. Qeveria të mundësojë dhënien me qera të godinave shtetërore në mbështetje të krijimit të qendrave të trajnimit për ridimensionimin e aftësimin të fuqisë punëtore në përputhje me kërkesat e tregut.

58 Përshtatja e kurrikulave të arsimit parauniversitar, pasuniversitar dhe formimit profesional me kërkesat e sektorëve prioritarë për investime (Mbledhje e KJ mbi Aftësitë e Tregut të Punës në Sektorin e BPO-ve).

Industri të caktuara me anë të zbatimit të projekteve dhe lëndëve mësimore nga ambienti i biznesit vendas. Fleksibilitet në ofrimin e dijes nga universitetet publike nëpërmjet programeve afatshkurtra inovative në partneritet me biznesin: Akademi Biznesi (programe intensive 1-3 ditore në një fushë të caktuar si p.sh. konsulencë në menaxhim dhe operacione, taksa, hartime planesh biznesi, studime fizibiliteti, etj.). Certifikatat e marra pas përfundimit me sukses të jenë të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë si një vlerë e shtuar për akses në tregun e punës (Mbledhje e KJ mbi Aftësitë e Tregut të Punës në Sektorin e BPO-ve).

Praktikat të standardizohen dhe të bëhen pjesë e kurrikulës - projekt model biznes - fakultet - praktika mësimore. Akreditimi i Universiteteve të konsiderojë monitorimin e marrëdhënieve shtet-biznes për zbatimin efektiv të praktikave si pjesë e kurrikulave (Mbledhje e KJ mbi Aftësitë e Tregut të Punës në Sektorin e BPO-ve).

SHTOJCA 1

Burimet Natyrore

1. BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË

» Vizioni strategjik

Qeveria është e angazhuar për mbështetje të politikave të rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme, kryesisht hidro, diellore dhe erës⁵⁹. Sipas ERE, për vitin 2017, prodhimi i energjisë për konsum publik u gjenerua plotësisht nga HEC-et, megjithëse një nga objektivat kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit për Burime të Rinovueshme të Energjisë 2015-2020 është diversifikimi në energji të rinovueshme. Vendi është i ekspozuar në një shkallë të konsiderueshme ndaj

rrezikut të pasigurisë së furnizimit, për shkak të ndryshimeve të kushteve hidrologjike. Qeveria shqiptare ka pranuar se nevoja për diversifikimin e burimeve të energjisë është urgjente⁶⁰.

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme 2018-2020, Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, përfshirë diversifikimin, me një fokus të veçantë në kapacitetet diellore dhe të erës. Objektivi kombëtar i prodhimit të energjisë në Shqipëri nga burimet e rinovueshme të energjisë në raport me konsumin final bruto është 38 përqind në vitin 2020⁶¹.

Pjesa e energjisë së rinovueshme e Shqipërisë në vitin 2009	Mesatarja për 2011-2012	Mesatarja për 2013-2014	Mesatarja për 2015-2016	Mesatarja për 2017-2018	Objektivi i energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në vitin 2020
31.2%	32.6%	33.2%	34.3%	35.6%	38%

59 Strategjia e Energjisë 2018-2030 e miratuar me VKM nr. 480, datë 31.07.2018. Objektivat në fushën e energjisë konsistojnë në përparësitë e mëposhtme: (1) shfrytëzimi i burimeve të energjisë; (2) diversifikimi i energjisë; (3) rritja e konkurrencës dhe (4) mbrojtja e mjedisit.

60 Siç përshkruhet në Planin Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme 2018-2020 të miratuar me VKM nr. 179, datë 28.03.2018 dhe konfirmuar gjithashtu në Planin e Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme 2019-2020 miratuar me VKM nr. 580, datë 28.08.2019.

61 Ligji nr. 7/2017 "Për nxitjet për përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme" dhe Planit Kombëtar i Veprimit i Konsoliduar.

» **Aktualisht, Shqipëria është vendi i vetëm në rajon me prodhimin 100% të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë.**

» **Kuadër i ri rregullator që mbështet vizionin** Ligji nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme” u miratua në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe Direktivën nr. 2009/28/EC “Për Burimet e Rinovueshme të Energjisë”. Ky ligj parashikon “masa mbështetëse”⁶² si një angazhim i drejtpërdrejt i Qeverisë në mënyrë që të arrihet objektivi në prodhimin dhe përdorimin e energjisë së prodhuar nga burime të rinovueshme.

Disa akte nënligjore⁶³ u miratuan në përputhje me Ligjin nr. 7/2017 (p.sh. VKM nr. 349 datë 12.06.2018 “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitim të tyre”, por shumë të tjera ende nuk janë miratuar (p.sh. krijimi i Agjencisë për Burime të Rinovueshme të Energjisë). Ligji për sektorin e energjisë parashikon përparësi dhe qasje të garantuar të energjisë së rinovueshme në rrjet dhe shpërndarjen prioritarë të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Sidoqoftë, legjislacioni dytësor nuk është i plotë. Në terma praktikë, operatorët e sistemit të transmetimit

dhe shpërndarjes duhet të përmirësojnë metodologjinë që përcakton kostot e lidhjes me rrjetin ose përforcimet e rrjetit dhe transparencën ndaj investitorëve.

» **Situata aktuale në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë në Shqipëri**

1. Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm për energji nga hidro, ku rreth 35% e tij shfrytëzohet. Një numër i konsiderueshëm i subjekteve private janë licencuar nga ERE mbi bazën e marrëveshjeve koncesionare për ndërtimin dhe funksionimin e HEC-ve të lidhura me qeverinë shqiptare. Ka rreth 540 HEC-e (527 HEC-e të vegjël deri në 2 MW) që përfaqësojnë 31% të parashikimit të gjenerimit, që është vetëm 43% e konsumit të energjisë elektrike e parashikuar në vitin 2020. Nga ndërtimi dhe operimi i HEC-eve që janë aktualisht fazën e ndërtimit, mund të rritet me rreth 8% në 2020 energjia e prodhuar nga hidrocentralet⁶⁴.

2. **30 kompani kanë aplikuar për parqet Eolike (energji nga era)**⁶⁵ - por ende nuk ka asnjë në fazë prodhimi. Energjia e erës përbën një mundësi potenciale për prodhimin e energjisë në Shqipëri. Problemi kryesor i ndërtimit të këtyre parqeve në Shqipëri është mungesa e matjeve të njëpasnjëshme të shpejtësisë dhe kohëzgjatjes së erës. Si pasojë, sipërmarrje të ndryshme të gatshme për të investuar në këtë fushë duhet të bëjnë vlerësimin e duhur të historikut të shpejtësisë së erës dhe kohëzgjatjes së saj përpara se të vendosin.

3. **11 kontrata të lidhura për prodhimin e en-**

64 AKBN Renewable Energy Overview 2019.

65 Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimt.

ergjisë nga fotovoltaike (panelet diellore) ndërsa numri i aplikimeve është më i lartë - vetëm prodhuesit e vegjël nën prodhim (kapaciteti deri në 2 MW) janë në fazë prodhimi. Rreth 10 muaj pasi u shpall fituesi i ankandit për ndërtimin e termocentralit fotovoltai Akernia në Vlorë, palët (Investitori dhe MIE) ende nuk kanë nënshkruar një kontratë që do t'i hapte rrugën një prej investimeve më të rëndësishme energjetike në vend. Fituesi i ankandit u njoftua në nëntor 2018, duke parashikuar ndërtimin e një termocentrali 100 MW. 50 MW do të ishte pjesë e masave mbështetëse që garantojnë blerjen e energjisë, ndërsa pjesa tjetër do të tregtohej lirshëm në tregun e energjisë⁶⁶. Në një rifillim të mundshëm të procedurave, ekziston interesimi i investitorëve të mëdhenj në tregun e energjisë për të qenë pjesë e një procesi transparent i cili le kohë të arsyeshme për përgatitjen e planeve të investimeve dhe të konsoliduara të biznesit.

» **Disa rekomandime të cilat mund të adresojnë dhe të nxitin investimet në këtë sektor:**

1. Vënia në zbatim e “masave mbështetëse” siç parashikohet në Ligjin nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme” në mënyrë që të arrihet objektivi në përdorimin e energjisë së prodhuar nga burime të rinovueshme.
2. Përcaktimi i çmimit të blerjes: Deri në miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga fotovoltaike sipas Udhëzimit

66 <https://acp.al/news/6759/Vonon-projekti-i-Parkut-fotovoltai-ne-Akerni-MIE-Jemi-ne-proces-nenshkrimi-te-kontrates/>

nr. 3 datë 20.06.2019.

3. Investimi në rrjetin e shpërndarjes së energjisë për të përmirësuar aksesin teknik për prodhuesit vendorë të energjisë diellore dhe të erës.
4. Bërja efektive e tregut të liberalizuar të energjisë dhe Bursës së Energjisë.

2. HIDROKARBURE⁶⁷

Sektori i naftës në Shqipëri konsiderohet relativisht i vogël sipas standardeve ndërkombëtare, por është i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë e cila ka ende rezerva të mëdha të pazbuluara të naftës. Ndërmarrja shtetërore e naftës, Albpetrol, vlerëson se rezervat gjeologjike të naftës së papërpunuar janë rreth 437 milion ton dhe rezervat totale të naftës bruto janë rreth 46,9 milion ton, rezervat e gazit natyror janë rreth 5,7 billion m³N. Bazuar në studimet gjeologjike, nga matjet e vjetra të Albpetrol dhe ato të kryera vitet e fundit nga kompanitë e huaja, rezulton se Shqipëria, përtej rezervave ekzistuese të naftës dhe gazit, ka ende një potencial shumë të madh dhe është zonë shumë premtuese për eksplorim të mëtejshëm. Aktualisht, gjashtë kompani kanë Marrëveshje për Ndarjen e Prodhimit (MNP) me kompaninë shtetërore të naftës ALBPETROL për zhvillimin dhe prodhimin në fushat ekzistuese të naftës. Eksplorimi dhe nxjerrja e burimeve të tilla është e kushtueshme duke kërkuar kështu investitorë të rëndësishëm dhe seriozë, fuqi punëtore të kualifikuar dhe një formulë të kombinuar që optimizon sasinë e nxjerrë, të ardhurat për buxhetin e shtetit dhe fitimet për kompanitë.

67 Informacion i detajuar për sektorin administrohet dhe publikohet në [faqen zyrtare të internetit](#) të AKBN.

62 Mbështetur me tarifa të rregulluara (feed-in-tariff) dhe CoD (Feed-in-premium)

63 Udhëzim nr. 3, datë 20.6.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”; VKM nr. 407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”; VKM nr. 342, datë 22.5.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”.

SHTOJCA 2

Matrica krahasuese e incentivave për investime në vendet e ballkanit perëndimor

Tetor 2019

Që në prill të vitit 2017, Sekretariati i Këshillit të Investimeve në bashkëpunim me AIDA përgatiti një matricë krahasuese të incentivave dhe elementëve më të rëndësishëm të barrës fiskale të zbatueshme në Shqipëri dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Mbledhjes V të Këshillit të Investimeve me temë *“Incentivat për Nxitjen e Investimeve: Shqipëria Përballë Vendeve të Ballkanit Perëndimor”*. Kjo matricë është risjellë e përditësuar si më poshtë në kuadër të Mbledhjes XVIII me temë *“Mbi Potencialet e Investimeve dhe Sektorët Prioritarë”*.

» Ajo që është e përbashkët për shumicën e vendeve, pjesë e matricës së përditësuar në Shtojcën 2, është se ato kanë miratuar një taksë

progresive mbi të ardhurat dhe norma të ndryshme të TVSH-së në varësi të sektorëve.

- » Për më tepër, Shqipëria aplikon një normë të reduktuar të tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, zbaton kufirin më të ulët të qarkullimit minimal për qëllime të TVSH-së prej 2 mln lekësh dhe ka zbatuar një paketë masash fiskale për turizmin dhe agro-turizmin në përpjekje për të nxitur ndërtimin e strukturave akomoduese.
- » Vende si Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë më agresive drejt targetimit të investitorëve në sektorë të tjerë nëpërmjet zonave të lira ekonomike kombëtare dhe rajonale dhe politikave të shpërblimit të drejtpërdrejt për çdo vend të ri pune të hapur në vend.

- » Theksojmë, se ndërsa taksimi njihet si faktor i rëndësishëm në vendimet e kompanive për të investuar, nuk është përcaktori kryesor⁶⁸. Investimet e Huaja Direkte tërhiqen nga ato vende që ofrojnë hyrje në tregje dhe mundësi fitimi, kornizë ligjore dhe rregullatore të parashikueshme dhe jo-diskriminuese, stabilitet makroekonomik, forcë punëtore të përgjegjshme dhe të aftë dhe infrastrukturë

të zhvilluar mirë. Janë të gjithë këta faktorë që në tërësinë e tyre ndikojnë në përfitimin afatgjatë të një projekti.

»

3. TË PËRBASHKËTA:

1. *Marrëveshje të Tregtisë së Livë si CEFTA dhe EFTA*
2. *Marrëveshje të Shmangies së Taksimit të Dyfishtë me shumë shtete*
3. *Kuadër Ligjor për Investimet dhe Mbrojtjen e Investimeve të Huaja*

68 Tax Effects on Foreign Direct Investment, OECD 2018

INCENTIVA	SHQIPËRIA	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA	MALI I ZI	KOSOVA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA
BARRA FISKALE						
<i>Norma e Fitimit të Korporatave</i>	15%	10%	15%	9%	10 %	10%
<i>Norma e tatimit në burim për interesat</i>	15%	15%	5%	9% për kompanitë jo rezidente dhe 5 % për individët jo rezident përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga marrëveshtjet për shmangien e tatimit të dyfishtë.	10 %	10 %
<i>Tatimi mbi të ardhurat personale</i>	0%, 13%, 23% ⁵	8% / 10% / 18%	Të ardhurat nga punësimi dhe të ardhurat nga biznesi 10%; Të ardhurat nga të drejtat e autorit dhe të ardhurat nga qiratë 20%; Të ardhurat nga kapitali 15% duke përfshirë nga tatimi shitjet e aseteve që kanë qenë në pronësi të shitësit për mbi 10 vjet.	9% Për të ardhurat nga punësimi mbi 766 Euro neto/muaj, norma tatimore është 11%. Për pagat e punonjësve të start up (përveç sektorit të agrikulturës, peshkimit, transport, ndërtimit të anijeve) janë të përfshiruara nga tatimi për 8 vjet deri në shumën totale 200,000 Euro.	10%	10%

68 Që prej 01.01.2017, niveli i të ardhurave të tatueshme për aplikimin e nivelit më të lartë të tatimit mbi të ardhurat individuale është ALL 130,001.

INCENTIVA	SHQIPËRIA	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA	MALI I ZI	KOSOVA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA
<i>Kontributi social i punëdhënësit</i>	16,7%	25,8%	17,9%	10% Baza maksimale për kontributet është 50,000 Euro në një vit kalendarik.	5% + 10% vullnetare	10,5%
<i>Kontributi social i punëmarrësit</i>	11,2%	27%	19,9% ⁶	24% ⁷	5% + 10% vullnetare	31%
<i>TVSH</i>	20% 6% per turizëm	18% normë standarte 5% normë e reduktuar (ushqime, kompjutera, programe kompjuterike, sistemet termike diellore, shitja e parë e ndërtesave të banimit)	20% 10% për ushqime bazike dhe shërbime publike	21% tatim-paguesit me xhiro mbi 18.000 EUR është subjekt TVSH 7% për ushqime bazë, barna, libra, shërbime publike dhe transport 0% TVSH për transport ndërkombëtar	18% normë standarte 8% taksë e reduktuar 0 për eksportet	17%
<i>Humbjet Tatimore</i>	Mbarten 3 vjet rresht.	Humbjet mund të mbarten për 3 vite rresht.	Mbarten 5 vjet rresht.	Humbjet tatimore, përfshi humbjet kapitale, mund të mbarten për 5 vjet rresht.	Mbarten deri në 7 vite rresht.	Humbjet mund të mbarten për 5 vite rresht.
<i>Rimbursimi i TVSH</i>	I menjëhershëm ose nga 30 – 60 ditë.	Rimbursimi i TVSH-së, bëhet menjëherë brenda 30 ditëve nga dorëzimi i deklaratës tatimore.		Investitori i huaj nuk duhet të paguajë çdo porosi në mallrat e eksportuara, por ka për detyrë të paguajë TVSH-në shkallë 0%, sipas Ligjit për TVSH-në. Kjo do të thotë se investitori i huaj që ka paguar TVSH për lëndët e para dhe në momentin kur ai eksporton produkte të përfunduar nuk do të paguajë TVSH, duke pasur të drejtën për kompensimin e TVSH për lëndët e para.	Çdo tre muaj për furnizime vendore nëse kreditimi është mbartuar 3 muaj rresht dhe në fund të muajit të tretë vlera e kreditimit kalon 3,000 euro. Në eksporte çdo muaj nëse kreditimi është mbi 3,000 euro.	

6 Komisioni për Sigurimin Shoqëror prej 19,9% përfshin: 14% - Sigurimi pensional dhe invaliditetit; 5,15% - Sigurim shëndetësor; 0,75% - Sigurimi i papunësisë
7 15% - Sigurimi pensional dhe invaliditetit; 8,5% - Sigurimi shëndetësor; dhe 0,5% - Sigurimi i papunësisë

INCENTIVA	SHQIPËRIA	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA	MALI I ZI	KOSOVA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA
INCENTIVA KONKRETE						
1. Fiskale	Përrjashtuar nga TVSH në import: 1. makineri dhe pajisje bujqësore, makineri përpunim aktiv dhe agro-biznes; 2. makineri të dedikuara për investime ≥ 360 000 EUR; 3. Importimi i makinerive dhe pajisjeve: a) në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë lekë; b) në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit; si dhe c) importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Përrjashtim taksa doganore importin e lëndëve të para dhe gjysëm të gatshme të destinuara për eksport. (Pezullim të taksës doganore dhe TVSH në import për mallrat që importohen nën regjimin e përpunimit aktiv).		Përrjashtim nga tatim fitimi për investitorët për një periudhë 10 vjeçare, nëse: • <i>ata investojnë në asetet fikse me një shumë që tejkalon rreth 9 milion €, dhe</i> • <i>të kenë të punësuar të paktën 100 punëtorë të deklaruar</i> Përrjashtim taksa doganore importin e lëndëve të para dhe gjysëm të gatshme të destinuara për eksport dhe në importin e makinerive dhe pajisjeve për investitorët e huaj.	Përrjashtim nga tatim fitimi për 3 vitet e para i jepet kompanive të angazhuara në aktivitetet e prodhimit në një zonë të pazhvilluar. <i>(Kjo incentivë nuk është e zbatueshme në sektorët e bujqësisë, të transportit, të ndërtimit të anijeve, të çelikut dhe të peshkimit.)</i>	Përrjashtim nga TVSH ne import për: - Mallrat që përpunohen për qëllime eksporti; - Pajisjet e IT-së; - Makineritë për prodhim; - Lëndët e para që futen në proces prodhimi. Përrjashtim nga taksat doganore për lëndët e para dhe makineritë në prodhim. Kthimi i akcizës për lëndë djegëse të harxhuara në proces prodhimi. Shpenzime të zbritshme për qëllime të Tatimit të Fitimit të Korporatave: Shpenzimet e përfaqësimit deri në 10% të fitimit para tatimit, plus 10% të tjera për sponsorizime. Shpenzim i zbritshëm prej 10% përtej shpenzimit të zhvlerësimit për makineritë e reja prodhuese në vitin e parë kur makineria është futur në përdorim.	Reduktim me 30% të taksës së fitimit kur investojnë në pajisje prodhimi më shumë se 50% të fitimeve korrente. Redukim me 50% të tatimit të fitimit kur investon nga fondet e veta 10 mln EUR në mënyrë të vazhdueshme në 5 vjet, jo më pak se 2 Mln EUR vitin I-rë. Konsiderohen shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore dyfishi i pagës bruto të punonjësve të rinj me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të jetë min. 12 muaj me kohë të plotë dhe punonjësi i ri të mos ketë punuar më parë më të njëjtin tatim-pagues në 5 vitet e fundit.

INCENTIVA	SHQIPËRIA	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA	MALI I ZI	KOSOVA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA
2. Zonat Ekonomike	2 zona në proces por jo aktive (Spitalla dhe Kopliku).	15 Zona Ekonomike, 3 plotësisht funksionale (Shkup 1 , Shkup 2 dhe Shtip) 1 është duke kaluar nëpër procedura të PPP (Tetovë). 11 të tjerë në faza të ndryshme të zhvillimit. Infrastruktura e ndërtuar nga shteti.	14 zona të miratuara, 12 zona operative.		N/A	
Incentiva fiskale brenda Zonave Ekonomike	50% e tatimit të fitimit për 5 vitet e para. Hyrja–dalja e mallrave sipas dispozitave të kodit doganor. Shpenzime të zbritshme 20% e kapitale vjetore për tre vitet e para. Furnizimi i mallrave shqiptare në zonë, konsiderohet si furnizim eksporti me shkallë zero. Zhvilluesi përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Ndërtimet përjashtohen nga taksa e pasurisë së paluajtshme për 5 vjet. Zhvilluesi dhe përdoruesi përjashtohen nga taksa e kalimit të pronësisë.	Përjashtimi nga tatimi mbi fitimin për një periudhë deri në dhjetë vjet nga dita e fillimit të aktivitetit në TIDZ. Në mënyrë që të shfrytëzojnë plotësisht këtë përjashtim të taksave, investitori duhet ta ketë filluar aktivitetin e biznesit jo më shumë se dy vjet pas marrjes së vendimit zyrtar për fillimin e punës në TIDZ. 2-Përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat personale mbi pagat e punonjësve, pavarësisht numrit të të punësuarve, për 10 vjeçarin e parë të aktivitetit në TIDZ. 3- Përjashtimi nga TVSH i furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve, përveç shitjeve tek konsumatori përfundimtar që kryhen brenda zonës ekonomike. 4- Përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të importit të mallrave që do të dërgohen në një zonë ekonomike, me kushtin që mos të shiten për konsum final.	0% TVSH për mallrat dhe shërbimet brenda zonave të lira dhe për ato që hyjnë në zonë. Furnizimi me energji dhe gaz me 0% TVSH. Hyrja dhe dalja e mallrave përjashtuar nga pagesa doganore. Përjashtim nga taksat lokale.		N/A	Përjashtim nga TVSH në importin e mallrave. Përjashtim nga detyrimet doganore për importimin e pajisjeve për prodhim.

INCENTIVA	SHQIPËRIA	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA	MALI I ZI	KOSOVA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA
Incentiva jo- fiskale brenda Zonave Ekonomike	Shpenzimet për paga dhe kontribute shoqërore të punëdhënësit njihen 150% të vlerës gjatë vitit të parë fiskal. Shpenzimet shtesë për pagat në vitet në vijim njihen si shpenzime me 150% të vlerës. Kosto trajnimi njihen shpenzime me dyfishin e vlerës për 10 vjet. Shpenzime për kërkim & zhvillim njihen me dyfishin e vlerës për 10 vjet.					
3. Incentiva jo-fiskale	Procedurë e asistuar nga AIDA sipas sektorëve dhe vlerës së investimit: 1. Energjetikë dhe minjera, transport, infrastrukturë, komunikime elektronike, mbetje urbane, për investime ≥ 30 mln EUR; 2. Turizëm min 80 vende të reja pune, TEDA ≥ 5 mln EUR; 3. Bujqësi dhe peshkim ≥ 3 mln EUR dhe min 50 vende të reja pune; 4. Zona me përparësi zhvillimi ≥ 1 mln EUR dhe min. 150 vende pune.		Reduktim i kontributit të punëdhënësit për punësime të reja për periudhën 1 korrik 2014 – 31 dhjetor 2017: 1 – 9 punësime të reja, 65% ulje; 10 – 99 punësime të reja, 70% ulje. Mbi 10 punësime të reja, 75% ulje. Vlerësohet se kjo redukton shpenzime paga për punëdhënësin në 20% .			
	Procedurë e vecantë miratimi nga Qeveria dhe shpronësim për: investime ≥ 50 mln EUR për sektorët më sipër; për investime ≥ 10 mln EUR dhe 600 vende pune në zonat me përparësi zhvillimi; Për çdo investim ≥ 100 mln EUR. SPECIFIKE: Dhënie me qira/enfiteozë e pronës shtetërore kundrejt çmimit 1 Euro.		Grante shtetërore për investimet edhe nga investitorë të huaj, projekte <i>greenfield</i> dhe <i>brownfield</i> në sektorin e manifakturës dhe për tregti ndërkombëtarë që variojnë nga 150.000 EUR deri në 600.000 EUR e koston së investimit ose mbulimi i kostove të punësimeve të reja në lidhje me investimin për një periudhë 2-vjeçare. Ndarja e fondeve sipas kriterëve: Nivelit të zhvillimit ekonomik të rajoneve; Vendeve të punës te reja nga min. 20 – 50 sipas rajoneve. Për sektorët <i>labor intensive</i> grantet mund të rriten progresivisht (me 10%, 15%, 20%) për punësime të reja (mbi 200, 500 dhe 1.000).			

INCENTIVA	SHQIPËRIA	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA	MALI I ZI	KOSOVA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA
4. Incentiva Sektoriale						
Bujqësia	Tatim-Fitimi 5% për Personat Juridike- Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor.	66 vende në dispozicion në 6 komuna: - Çmimi i ofertave- Fillimi prej € 1 / m²; - Çmimi i ofertave- Fillimi prej € 0,1 / m² për 99 vit qira; - Madhësia mesatare lokacioni: 3.000m ² - 4.000m²; - Ndihma shtetërore në formën e bashkëfinancimit në dispozicion. Tatimi mbi të ardhurat: Për personat që kryejnë aktivitet bujqësor si profesion primar, përjashtimet e taksave në vijim janë të lejuara: - Deri në 300.000 denarë (të ardhura), ata kanë të lejuara 100% shpenzime të standardizuara dhe - Nga 300.001 deri në 1.300.000 dinarë (të ardhura), ata janë të lejuar 80% të shpenzimeve të standardizuara. Për personat që kryejnë veprimtari bujqësore si profesion shtesë, shpenzimet e standardizuara janë përcaktuar në shumën prej 80% nga të ardhurat e realizuara.	Pagesa direkte nga 80.000 EUR – 160.000 EUR. Incentiva të dedikuara për zhvillim rural. Incentiva specifike për asistencë teknike dhe profesionale.			

INCENTIVA	SHQIPËRIA	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA	MALI I ZI	KOSOVA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA
Turizmi	6% TVSH për strukturat akomoduese (Fjetje + Mëngjes); 6% Tvsh për çdo furnizim brenda strukturave “Hotel/Resort 5*, Status Special” (<i>Brand Name</i>); Përjashtim nga taksa e ndërtesës dhe taksa e ndikimit infrastrukturë Hotel/Resort 5*, status special” (<i>Brand Name</i>); Përjashtimi Nga Tatim Fitimi për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, “Hotel/Resort 4* dhe 5*, status special” të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024; 6% Tvsh për subjektet e certifikuara në agro-turizëm (Fjetje + Restorant (pa pije); Përjashtimi nga taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për operatorët agro-turistikë që do të bëjnë investime në këtë fushë; Nga 1 janari 2018 për subjektet e certifikuara në agro-turizëm tatim fitimi ulet nga 15% në 5%.	Reduktimi i TVSH për turizmin nga 18% në 5%. •Tërheqja e investitorëve të huaj për ndërtimin e hoteleve & objektet turistike; • Pa pagesë zonat e zhvillimit të turizmit. • Subvencionet për Operatori Turistike si më poshtë: Në varësi të vendeve nga vinin turistët, për çdo turist operatori turistik përfiton nga 10-25 Euro; Për transportin e turistëve me tren, operatori përfiton 15 euro për turist; Për transport të kombinuar (guida turistike) nga 10-15 Euro për turist.		Përjashtim i TVSH në import për produktet dhe shërbimet për ndërtimin e hoteleve me 5 vje. Reduktim i taksës së pasurisë me 30% për hotelet me 4 vje dhe 70% për hotelet me 5 vje. Mbështetje me grante për Veriun e Malit të Zi për investime në turizëm minimum 500,000 EUR dhe min 20 vende pune brenda 3 viteve (ndërtimi i hoteleve mbi 3 vje).		
IT	5% tatim fitim prodhim/zhvillim software					

Kjo Përmbledhje është përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në bashkëpunim me AIDA. Kjo përmbledhje përmban informacion të marrë nga ligje, akte nën-ligjore, dokumenta, website të tjera pjesë e domain-it publik. Informacioni i përfshirë në këtë përmbledhje nuk është shterues dhe nuk zëvendëson asistencën apo këshillimin profesional që mund t’ju duhet ju apo kompanisë tuaj për të marrë vendime, si edhe nuk duhet të përdoret si bazë për ndonjë vendim ose veprim që mund të ndikojnë financat apo biznesin tuaj. Përpara marrjes së ndonjë vendimi që lidhet me sa më sipër, ju lutem konsultoni legjislacionin përkatës të zbatueshëm në vendet përkatëse. Sekretariati i Këshillit të Investimeve nuk është përgjegjës mbi saktësinë e këtij informacioni dhe as mbi ndonjë vendim të marrë nga ju mbi bazën e informacionit të dhënë në këtë përmbledhje.

BIBLIOGRAFIA

1. *Plani Shumëvjecar i Veprimit për një Zonë Ekonomike Rajonale në 6 Vendet e Ballkanit Perëndimor (MAPREA)*
2. *Ligji nr. 7764/1993 “Për Investimet e Huaja” i ndryshuar me Ligjin nr. 10316 datë 26.09.2010 dhe Ligjin nr. 46/2017 datë 13.04.2017*
3. *Ligji nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike” (i ndryshuar)*
4. *Ligji nr. 9789/2007 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave Ekonomike” ndryshuar me Ligjin nr. 54/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik” i cili parashikoi incentiva fiskale konkrete për veprimtaritë ekonomike të industrive të reja, teknologjive novatore, teknologjive të informacionit, industrive që përmbushin standardet ndërkombëtare të eliminimit të ndotjes, industrive efçente në përdorimin e energjisë, si dhe industrive me produktivitet të lartë, në raport me punonjësit*
5. *Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, i ndryshuar me Ligjin nr. 88/2014 dhe 77/2015 objekt i diskutimeve së fundmi në lidhje me kufizimin e PPP për ofertat e pakërkuara*
6. *Udhërrëfyesi i Politikës së Investimeve të Qeverisë Shqiptare miratuar me VKM nr. 579 datë 03.08.2016*
7. *Progres Raporti 2019, BE*
8. *Strategjia e Energjisë 2018-2030 miratuar me VKM nr. 480 datë 31.07.2018.*
9. *Plani i Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 2019–2020 miratuar me VKM nr. 580 datë 28.08.2019 i cili zëvendësoi Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 2018–2020 miratuar me VKM nr. 179 datë 28.03.2018*
10. *Ligji nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme”*
11. *Udhëzim nr. 3, datë 20.6.2019 “Për miratimin e procedurës së Lehtësuar të autorizimit*

- për Lidhjen në sistemin e Shpërndarjes të projekteve të Vogla të rinovueshme për Vetëprodhuesit e energjisë Elektrike nga dielli”*
12. *VKM nr. 407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”*
13. *VKM nr. 342, datë 22.5.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”*
14. *Western Balkan Regular Economic Report, Reform Momentum Needed, Spring 2019, World Bank Group*
15. *“World Economic Outlook, Growth Slowdown, Precarious Recovery”, International Monetary Fund, April 2019*
16. *“World Investment Report 2019, Special Economic Zones, UNCTAD*
17. *“2019 Index of Economic Freedom, The Heritage Foundation*

18. *Corruption Perception Index 2018, Transparency International*
19. *“Doing Business 2019, Training for Reform”, World Bank Group*
20. *“Tax Effects on Foreign Direct Investment”, OECD 2018*
21. *“Reversing Brain Drain with the Albanian Scientific Diaspora” Research study, March 2018 UNDP*
22. *Programi qeverisës 2017–2021*
23. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020*
24. *Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Biznesit 2014-2020*
25. *Ligji 54/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*
26. *Banka e Shqipërisë*
27. *INSTAT*

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council